



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Më datë: 09.01.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 90 të Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr.04/L-027, në dispozitat e Rregullores Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësia Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr. 28/2008), neni 43 dhe 44 të Statutit të Komunës Nr. 98 të datës 17.08.2012 mori:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

1. Formohet komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026.
2. Komisioni përbëhet prej anëtarëve si në vijim:
 - 2.1. Faik Dedinca – Shef i Sektorit për Bujqësi - Kryetar i Komisionit;
 - 2.2. Gëzim Shabani – Zyrtar për Ndërmarrje Publike - anëtar;
 - 2.3. Nexhat Bajqinca – Zyrtar i Lartë për Makineri - anëtar;
 - 2.4. Arbnor Rushiti – Zyrtar për Makineri - anëtar;
 - 2.5. Muhamet Xhigoli – Zyrtar i Pasurisë - anëtar.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi është vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përgatitja e propozimeve për rimëkëmbjen nga dëmet e shkaktuara dhe kryerja e detyrave dhe veprimeve tjera në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera me Nr. 04/L-027 dhe dispozitat e Rregullores Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
4. Komisioni për punën e tij përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e Komunës dhe i dorëzon Kryetarit të Komunës për shqyrtim.
5. Ky vendim hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorive të Komunës
- 1x Anëtarëve të Komisionit
- 1x Arkivit

Kryetari i Komunës
Valon Prebreza

